

# *“Diplomacia merimangë” si shpjegim plotësues i rrethanave të reja ndërkombëtare*

Bejtush Gashi\*

Gurakuç Kuçi\*\*

## **Abstrakt**

Shekulli i ri me dinamikën e marrëdhënieve ndërkombëtare, ka sfiduar teoritë, siç i quante Popper ‘strikte universale’ dhe nevojën për shpjegime teorike ‘numerike universale’. Shekulli XX ka zhvilluar teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare, por sot këto teori janë në betejë me *ndryshimet* e shpjegimeve sesa me *zgjerimin* e kuadrit teorik. Nevoja për shpjegime të reja, nuk i hedh poshtë teoritë e vjetra, vetëm kërkon që aksiomat e tyre të jenë më inter-teorike dhe me variabla të rinj, që shpjegojnë rrjedhën e veprimeve të paramenduara të aktorëve shtetërorë deri në qëllimin e caktuar. Pra, ky *ndryshim* teorik dhe marrja e disa *aksiomave realiste*, duke shtuar *variabla* inter-teorike (pragmatizmin, analizën e politikës së jashtme, realizimin ofensivë, dhe realizimin defensivë) na dërgon te një teorizim që e kemi quajtur “*diplomacia merimangë*”.

Almond në vitet ‘60 konsideronte se “me rënien e normave dhe traditave të shkencave politike, është rritur nevoja për teori dhe teoricienët politikë”, ku edhe sot hasim në gjendjen e njëjtë për shpjegimin e rrethanave të reja gjeopolitike dhe gjeostrategjike. Nëpërmjet “*diplomacisë merimangë*” tentojmë të bëjmë studime empirike, induktive, të mundshme dhe të testueshme bazuar në tri iniciativa të subjekteve ndërkombëtare (nga

---

\* Prof. Assoc. Dr. Bejtush Gashi, Fakulteti i Sigurisë Publike (dekan), KPSF, Vushtrri; ligjërues në Kolegjin AAB. Ministër i brendshëm i Republikës së Kosovës. Email: [bejtush.gashi@rks-gov.net](mailto:bejtush.gashi@rks-gov.net), [bejtushg2002@yahoo.com](mailto:bejtushg2002@yahoo.com)

\*\* Gurakuç Kuçi, PhD Candidate, drejtor i përgjithshëm i “Independent Institute for Political and Media Studies”.

Email: [gurakuc.kuci@unite.edu.mk](mailto:gurakuc.kuci@unite.edu.mk), [gurakuquqi@gmail.com](mailto:gurakuquqi@gmail.com)

aktorët shtetërorë të aktorët joshtetërorë; nga aktorët shtetërorë të aktorët e tjerë shtetërorë dhe, mikst).

Me këtë hulumtim kemi analizuar shkaqet dhe kronologjinë e një rrjeti diplomatik, shtrirjen që po tenton ta bëjë Rusia sot dhe Serbia ndaj shtetit të ri të Kosovës. Por, për ilustrim kemi marrë edhe një shembull nga e kaluara, një nga luftërat e Izraelit me vendet arabe. Ne kemi gjetur rezultate të verifikueshme, pragmatike dhe analitike që e provojnë skemën e “diplomacisë merimangë”.

**Fjalë kyç:** *diplomaci merimangë, realizëm, Ballkani Perëndimor, Izraeli, Rusia, Serbia*

Që nga periudha antike, njerëzimi është munduar që të gjejë forma dhe mënyra për shpjegimin dhe parashikimin e ngjarjeve, madje shpjegimet dhe parashikimet rrjedhin qysh nga veprimet primitive të besëtytnive qofshin edhe ato nga sfera politike, sociale, e luftërave dhe ekonomike. Civilizimi grek arriti që në shumë sfera të shkencave sociale por edhe ekzakte të japë fillesat shkencore qofshin ato të sakta apo të gabuara, nga sofistët, si dhe Hesoidi, Pitagora, Platoni, Aristoteli, Alcidimusi, janë vetëm disa emra që kanë kontribuar aq shumë në ndarjen e normatives me natyroren. Kanë arritur që të bindin vetveten dhe të tjerët se asgjë nuk është absolute dhe shoqëria evoluon, pra “teoria e ndryshimit”, pastaj për të vazhduar me “teorinë e ndryshimit të identitetit të kundërt”. Protagora është ai i pari që është marrë me teorinë e ndryshimit ndërmjet natyrës dhe shoqërisë, ndërsa Platoni ka shkruar për “teorinë e formave” dhe rikthimin te gjeneza. Madje, Platoni ka pasur një drejtësi totalitare, duke e bërë edhe shkencën totalitare që në shumë qasje mund t’i afrohet nëse jo njësohet pozitivizmin. Është Karl Popper, i cili na jep argumente të fuqishme për të çmontuar njëherë totalitarizmin e Platonit, Hegelit dhe Marksit me veprat e tij për shoqërinë e hapur, e më pas me veprën e tij “Logjika e Hulumtimit Shkencor”. Me këtë,

Popper hap dyert që të kalojmë në postpozitivëm, ku shkenca mund të jetë e hapur dhe me argumente më shumë se me norma strikte të shpjegojmë dhe parashikojmë ngjarje. Popper nuk beson në teori absolute, madje ai thotë se çdo teori një ditë do të jetë e pavlefshme.

### *A mund të kemi teori të reja?*

Shumë pyetje themelore janë ngritur mbi atë se përse ne kemi nevojë për teori, kur mund t'i pyesim aktorët drejtpërdrejt, apo një tjetër problem më themelor, se bota nuk është aq e thjeshtë dhe njerëzit plotësisht të vetëdijshëm se pse ata veprojnë në mënyra të caktuara (S. Smith 2013).

Por, a mund të kemi ne besim në përgjigjet që i marrim nga aktorë të ndryshëm, nëse do merrnim përgjigjeje të sinqerta, atëherë ne nuk kemi nevojë për teori. Thjesht do mjaftonin mediat të cilat do bënin raportime. Por, bota nuk funksionon në mënyrë të tillë. Dhe kemi nevojë për qasje teorike të cilat na ndihmojnë të ndjekim dhe shpjegojmë veprimet e aktorëve ndërkombëtarë.

Sidoqoftë, teoritë jo çdo herë kanë marrë gjithë besimin e nevojshëm për të shpjeguar dhe parashikuar veprimet e aktorëve ndërkombëtarë. Teoritë nuk janë të vërteta të pakontestueshme. Pra, marrëdhëniet ndërkombëtare dallohen nga disiplinat e tjera të shkencës nga ana e karakterit të veçantë; ato janë poliarkike, plurale, komplekse dhe impulsive (Sielski 2007).

Teoritë janë rrjete për të kapur atë që ne e quajmë “botë”, për ta racionalizuar, shpjeguar dhe për ta zotëruar atë (Popper, 2002). Teoritë apo qëndrimet kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare, janë teori universale, apo siç i quan Popperi, “teori strikte universale”. Këto teori me dinamikën e marrëdhënieve ndërkombëtare kanë pësuar ndryshime dhe

*neo-izma* të rinj për shpjegimin e rrethanave të reja. Madje për të shkuar edhe më tej, pas incidentit të 11 shtatorit ka pasur një debat rreth vlefshmërisë së teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare (Bunyavejchewin 2012).

Duhet kujtuar se debati mbi vlefshmërinë e teorive nuk është tentativë e shekullit XXI.

Mills thoshte se ndërtimi i një *teorie të madhe* do të ishte vetëm një pengesë në zhvillimin e shkencave humane. Në vitet e '90 Lemart thoshte se është një tendencë e natyrshme e mendimit shoqëror që të lirohesh nga presioni për të vënë në dyshim natyrën e kësaj që po ndodh rreth nesh. Një skepticizëm i tillë mund të vihet re edhe te Bell (1960), në librin e tij "The End of Ideology", ose në veprën e Aronit (1955) "The Intellectuals Opium". Të dy studiuesit pretenduan se ka kaluar koha e ndërtimit të teorive të mëdha që kishin bazë ideologjike. Isaiah Berlin në vitet '70, kishte shkruar një artikull provokues me titullin: "Does Political Theory Exists?", duke e rishkruar dhe botuar atë në vitet e '80 (Sielski 2007). Sidoqoftë, ekzistenca dhe vazhdimësia e teorive ndërkombëtare, e sidomos atyre të zakonshme, nuk mund të vihet për asnjë moment në dyshim, sidomos për nga kuptimi si "teori strikte universale".

Mund ta kemi sot të pamundur që të shpjegojmë dhe parashikojmë ngjarjet ndërkombëtare pa teoritë e mëdha ndërkombëtare. Por, do ta kemi të pamundur po ashtu të shpjegojmë dhe parashikojmë edhe shumë ngjarje ndërkombëtare nëse mbesim pre e dogmës dhe traditës së teorive të mëdha. Almond, në vitet e '60, me një punim shkencor të tij mbi teoritë e shkencave politike, pretendonte se rritja e teoricienëve të këtij lëmi përkon me largimin nga normat dhe traditat e shkencave politike, ku po e shtyn edhe rritjen e numrit të teorive politike (Almond 1966).

Andaj, për shpjegimin dhe parashikimin e ngjarjeve të ndryshme të shekullit XXI, nxjerrja e teorive të reja bazuar të

teoritë e mëdha, na lejon qasje për shpjegime dhe parashikime më adekuate, duke u bazuar në modelin e dytë teorik të Popperit, “universalitetin numerik” apo ndryshe “qëndrimet njëjës”. Qëndrime të këtij lloji, në parim, mund të zëvendësohen nga një bashkim i qëndrimeve njëjës; për kohë të mjaftueshme, mund të numërohen të gjitha elementet që kanë lidhje me klasën (e caktuar). Kjo është arsyeja pse ne flasim në raste të tilla për “universalitetin numerik” (Popper 2002).

Duke u bazuar në *universalitetin numerik* ne mund të kemi ngjarje dhe veprime në marrëdhëniet ndërkombëtare, të tilla që nuk kanë një shpjegim thelbësor nga teoritë e mëdha dhe janë të tilla veprime që duan një shpjegim dhe parashikim të veçantë, gjë që bie ndesh me atë që mbulojnë *teoritë strikte universale*. Pra, në raste dhe veprime të ndryshme të aktorëve ndërkombëtare, ne kemi nevojë për shpjegime *hibride teorike*, dhe që nuk janë të përgjithshme, por janë *qëndrime njëjës apo universale numerike*.

Ne nuk mund të shpjegojmë me teorinë realiste mjaftueshëm, përkrahjen e një aktori ndërkombëtar, të grupeve terroriste kundër një aktori ndërkombëtar, por as thirrjen demagogjike të Ruisë për paqe në Siri. Apo as veprimet e Kinës për investime për vende të reja pune në disa pjesë të botës, kur vetë një pjesë e popullit të saj përballet me varfëri dhe probleme të mëdha për një jetë të mirëqenë.

Pra, duke shtyrë përpara ndryshimet teorike dhe krijimin e teorive hibride, ne vijmë te një këndvështrim funksional i ndërtimit të teorisë. Nga këndvështrimi funksional, P. Sztompka thoshte se teoria mund të bëhet duke theksuar funksionet e saj autonome - teoria si një mjet për ndërtimin e një teorie. Sztompka gjithashtu thoshte se mund të theksohet funksioni i tij instrumental - duke e kuptuar teorinë si një grup teoremash që lejojnë një veprim praktik, ose një grup teoremash

që mundësojnë shpjegimin e fakteve apo përgjithësimeve – përgjigjet në pyetjen “pse?” (Sielski 2007).

Duke e marrë teorinë si në mjet për ndërtimin e një teorie, së bashku me funksionet autonome të teorisë, mund të marrim teorema dhe aksioma sipas nevojës nga *teoritë strikte universale* që do na lejonin dhe ndihmonin të krijojmë teorinë hibride të nevojshme dhe të testueshme *numerike universale*, dhe na mundëson shpjegimin e fakteve dhe parashikimin e ngjarjeve duke iu përgjigjur pyetjes “Pse?”. Por, duhet ta kemi parasysh dhe të japim një sqarim për nevojat tona hulumtuese se teoritë ndahen në pesë kategori: teoritë e mëdha, teoritë e përgjithshme të disiplinave të caktuara shkencore, teoritë e një zone të gjerë, teoritë e zonës së mesme dhe teoritë e detajeve (Sielski 2007).

Duke pasur parasysh ndarjen e mësipërme, duhet të kemi parasysh se çështja e meta-teorisë nuk sjell një problem në çështjen e studimit teorik, pasi kur kemi parasysh kategoritë na del që çdo kategori është meta-teori e kategorisë paraprake. Përveç tjerash meta-teoria ka pasur një debat se a është shkencore apo jo, por te hulumtimi ynë në këtë fazë, nuk pranohet për shpjegim.

Pasi tentuam që përkitazi për nevojat tona hulumtuese të shtjellojmë një bazë teorike për teori të reja hibride, jemi në një pozicion të shpjegojmë një skemë hibride teorike e cila do mundohet që të mbushë aty ku mundet dhe të sqarojë në një mënyrë realiste hibride veprimet e aktorëve ndërkombëtarë.

### *Teoritë ndërkombëtare dhe ‘një teori asnjëse’*

Studimi i çështjeve ndërkombëtare është kuptuar më mirë si një konkurrencë e zgjatur midis traditave realiste, liberale dhe radikale. Realizmi thekson prirjen e qëndrueshme për konflikt midis shteteve; liberalizmi identifikon disa mënyra për të

zbutur këto tendenca konfliktuale; dhe tradita radikale përshkruan se si mund të jetë i tërë sistemi i marrëdhënieve shtetërore (Walt 1998).

Teoritë e marrëdhënieve ndërkombëtare në shpjegimin e tyre mbajnë në thelb mbrojtjen e aksiomave të tyre doemos duke mbrojtur apo edhe përshkruar në kuadër të teorisë veprimet e aktorëve ndërkombëtar. Madje, teoritë e mëdha ndërkombëtare arrijnë që me elokuencë të mbizotërojnë mbi njëra-tjetrën gjithnjë duke qenë të varur nga dogma e tyre teorike dhe normative. Nganjëherë mbrojnë me aq bindje tendencat e tyre sa ka synime të kalohet nga falsifikueshmëria teorike në atë ekzakte.

Kritika ndaj studiuesve të marrëdhënieve ndërkombëtare, çdo ditë e më shumë është më e madhe. Profesionistët e fushës nuk po arrijnë të shpjegojnë ngjarjet të paktën të përafrojnë parashikimet dhe kjo pasi ata duke qenë të fokusuar më shumë në teori dhe modele ku parashikojnë sjellje racionale konform parashikimeve të teorive dhe racionalizmit realist apo liberalist, nuk arrijnë të shpjegojnë ngjarje dhe dilema të cilat janë një hibridizim dhe një piramidë e përmbysur karshi teorive të mëdha dhe neo-ve të tyre të pas Luftës së Dytë Botërore. Kush e parashikoi që do mund të vinte deri te një takim i Presidentit të SHBA-ve Trump me diktatorin e Koresë së Veriut?

Por, duhet ta kemi të qartë që aktorët ndërkombëtarë nuk hartojnë teori, por vetëm ngjarje dhe teori hartojnë studiuesit. Andaj nevojitet njëfarë empirizmi pragmatik akademik për të shkuar më tutje nga traditat e teorive me koncepte të Luftës së Ftohtë.

Shmangia nga 'izmat' është një qasje që do na lejonte të largoheshim nga dogma dhe ideologjia se një teori patjetër duhet të përfaqësojë një rrymë ideologjike e cila shpjegon veprimet e një aktori. Fatkeqësisht ashtu si ekonomistët sipas Sharma-s (2017), edhe studiuesit e marrëdhënieve

ndërkombëtare janë të prirur të injorojnë çdo faktor që është shumë i komplikuar për t'u kuantifikuar ose inkorporuar në një model shpjegimi ose parashikimi. Dhe kjo jo nga mosdija, por nga frika e eksperimentimit duke e kthyer konceptin *teori* në *saktësinë e përbotshme* që ngjan më shumë me pozitivizmin, sesa me *testueshmerinë* dhe *falsifikueshmerinë*. Ose nëse vazhdojmë me vetëm një qasje tradicionale, një ditë mund të shkojmë drejt *teorisë së turmave* edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të ekonomistit Surowiecki (2005), apo të *Ligjit të Goodhart-it* (Goodhart 1984).

Nëse duam më shumë qartësi shkencore dhe pragmatike të veprimeve të aktorëve ndërkombëtarë, atëherë duhet të shmangemi nga defensiva dhe eksperimentimi teorik, testimi i aksiomave të ndryshme me nënfusha të teorive të marrëdhënieve ndërkombëtare, duke i përdorur ato edhe si *variabla teorike*.

Nuk ka entitete permanente në fushën shoqërore, ku çdo gjë është në tundjen e fluksit historik (Popper, 1950). Pra, ne nuk biem ndesh me *esencializmin metodologjik* që e zhvillon Popperi. Përveç, të tjerash nuk duam të pranojmë një dogmë shkencore teistike dhe të kemi priftërinj shkencorë, apo ta ringjallim edhe një herë pozitivizmin, por të jemi gjithnjë në hulumtim të kapjes së një të vërtete të falsifikueshme, të testueshme, të observueshme dhe parashikueshme.


### *Një shembull nga e kaluara për ndërtimin e një teorie hibride për nevojat bashkëkohore*

Pas luftës, më 1957, Izraeli fitoi një reputacion të besueshëm mbi fuqinë e tij sulmuese dhe parandaluese. Nasser duke e njohur tani këtë fuqi të Izraelit dhe dobësinë e vendit të tij dhe vendeve arabe për nga fuqia ushtarake dhe uniteti për izolimin e Izraelit, vendosi që të vetëpërmbahet përkundër presioneve



politike që i vinin nga vendet arabe (C. Smith 2004). Sidoqoftë, Izraeli i cili përfitonte nga gabimet e vendeve arabe, nuk ishte në favor të lejimit të një paqeje në Lindjen e Mesme, që gjatë kësaj periudhe do t’u mundësonte potencialisht vendeve arabe të konsolidoheshin ushtarakisht dhe politikisht. Andaj, edhe dëshironte që rajonin ta mbante çdo herë në gjendje lufte dhe të përfitojë nga veprimet. Për të provokuar insinuata dhe pakënaqësi ndërmjet vetë vendeve arabe dhe të krijonte gjendje lufte, Izraeli mori një varg veprimesh konkrete.

Veprimet e paraqitura ne fig. 1. tregojnë se veprimet merimangë të Izraelit kanë për bazë edhe teorinë imponuese, ku tregohet se ndërveprimet e Izraelit kanë ngjallë edhe reagime brenda vetë botës arabe dhe pakënaqësi të shumta ndaj Egjiptit dhe regjimit të Naserit. Pra, diplomacia merimangë jep mundësinë që të ndërëveprojë nëpërmjet imponimit dhe shfrytëzimit të ngjarjeve duke i kthyer në favor të saj, si në rastin tonë tek Izraeli. Izraeli përveç se shënoi pika strategjike përfituese, qëllimi i tij ishte përfitimi i njohjes nga Egjipti dhe ndryshimin e qasjes së Egjiptit, madje duke ia ofruar rikthimin këtij të fundit të Sinait në këmbim të njohjes (C. Smith 2004).



**Figure 1.** *Diplomacia Merimangë e Izraelit*

Kjo pjesë është shkruar për nevoja të hulumtimit, dhe se sigurisht që ka shumë pjesë që mund t'i shtohen, por nevojitet një bazë pragmatike për analizë të jashtme realiste ofensive dhe defensive të një aktori ndërkombëtar.

Pra nga kjo skemë e sipërpërmendur kemi nxjerrë konstatimin se ka një korrelacion ngjarjesh të paramenduara të cilat prodhojnë efekte të synuara, sikur një teori që faktori A prodhon shkakun B, e që më këtë e kemi quajtur “diplomacia merimangë”.

### *Zhvillimi i teorisë në kontekstin e analizës së “diplomacisë merimangë”*

Fillimi i shkencave politike dhe më vonë i marrëdhënieve ndërkombëtare si shkencë dhe praktikë ka pasur një ballafaqim jo të vogël nga ndarja me sferën ekonomike. Nëse të gjitha shtetet intervenojnë për të rregulluar dhe kufizuar problemet

me tregjet ekonomike dhe tregjet krijojnë efekte që ndikojnë në sjelljen e shteteve (Rosenberg 1994), atëherë përse ka qenë e nevojshme disiplina e marrëdhënieve ndërkombëtare, apo shkencat politike në përgjithësi? Rosenber thjesht na hap dyert se për përgjigjeje më të thella neve na nevojitet që të shkojmë jashtë disiplinës ekzistuese... (Rosenberg 1994).

Krijimi i disiplinave studimore ka mbuluar shumë boshllëqe të të kuptuarit të praktikave dhe veprimit të shteteve. Si do të arrinim të kuptonim Krizën e raketave në Kubë, nëse marrëdhëniet ndërkombëtare nuk do të ishin një disiplinë më vete?

Çdo disiplinë dhe nënfushë politike ka një ngritje të saj dhe një proces jo rrallëherë të gjatë dhe shumë kontradiktor, sidomos kur përballlet me strategji të reja pragmatike si; strategjia e George W. Bush për “lufta parandaluese”, e Barack Obamës “strategjia e durimit”, pastaj e fundit nga Donald Trump, “përgjegjësia strategjike”, apo “strategjia e kaosit” nga Gjenerali rus Valery Gerasimov etj.

Me teorinë e aktorit gjeneral në marrëdhëniet ndërkombëtare (Hudson 2005) që funksionon me metodën e deduksionit të hulumtimit dhe me metodën hulumtuese të induksionit, dy forma të ndryshme të hulumtimit, te diplomacia merimangë, mund të funksionojnë si dy qasje të nevojshme që përdoren pa ia humbur kuptimin hibrid diplomacisë merimangë dhe na japin një metodë praktike të bashkëpunimit.


Kjo pasi, siç e shpjegon Lane, analiza e politikës së jashtme është e pozicionuar për të siguruar teorinë konkrete që mund të ringjallë lidhjen midis teorisë së aktorit të përgjithshëm në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe themelimit të shkencës shoqërore (Lane 1990).

Këtu dalim te nivelet e analizës ku tri prej tyre ndikojnë drejtpërdrejt marrëdhëniet ndërkombëtare. Ndërsa, tek analizimi i “diplomacisë merimangë”, duhet të jemi brenda

nivelit ndërshtetëror në bashkëpunim me influencat, si: pushteti (lufta dhe diplomacia), balanca e fuqive (traktatet dhe samitet), formimi i aleancave (marrëveshjet tregtare dhe ujdite) dhe shpërbërja e aleancave (OQN-të dhe reciprociteti) (Goldstein and Pevehouse 2014).

### *Paradigmat e “diplomacisë merimangë”*

Si një lloj prove për të nxjerrë stadi të hollësues të shpjegimit të “diplomacisë merimangë” jemi ndalur te dy shembuj të shpejtë, ku njëri ka të bëjë me Rusinë dhe tjetri me Ballkanin Perëndimor.



**Figure 2.** *Diplomacia Merimangë nga Rusia*

Ambasadori i Ukrainës në Serbi, Oleksand Aleksandrovych, deklaronte se: “Rusia po trajnon mercenarë serbë për të vrarë në Ukrainë. Rusia po shfrytëzon ekstremistët serbë për të bërë grusht shtet në Mal të Zi. Rusia Inkurajon separatizmin serb në Republika Serpska për ta destabilizuar Bosnjën dhe Hercegovinën. Rusia po shfrytëzon faktorin serb për ta destabilizuar Maqedoninë. Rusia po luan një rol aktiv për të kundërvënë serbët e Kosovës kundër shqiptarëve në Kosovë.

Rusia po shtet armë te Serbia për të krijuar tensione me Kroacinë (Zivanovic 2017).

Nëse shikojmë Figurën 1, atëherë nxjerrim një koncept dy nivelesh të “diplomacisë merimangë”, nivelin ku këmbët e saj janë te një aktor shtetëror diku tjetër dhe, koka diku tjetër.

Pra, “diplomacia merimangë”, ngërthen në vete tri nënkoncepte:

1. Diplomacia merimangë me bazë nga aktorët shtetërorë tek aktorët joshtetërorë;
2. Diplomacia merimangë me bazë nga aktorët shtetërorë tek aktorët tjerë shtetërorë dhe,
3. Diplomacia merimangë mikst.

Te rasti i Ruisë bazuar në Figurën 1, kemi situatën e një diplomacie me gjashtë elementë ndikimi, ku pesë nga ta i përkasin nënkonceptit *mikst* dhe vetëm një konceptit *aktor shtetëror me aktor shtetëror*.

Një ilustrim tjetër kronologjik mund të marrim deklaratat dhe veprimet e politikanëve në qeverisje në Serbi karshi Kosovës.

Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, para takimit joformal me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, deklaroi se duhet dialog për fatin e serbëve jo në veri të Mitrovicës, por brenda Kosovës sepse ata janë të pambrojtur dhe të diskriminuar (B92 2017).



**Figure 3.** *Diplomacia Merimangë e Serbisë*

Ana Brnabiç, kryeministrja e Serbisë, më pas deklaroi se duhet një dialog për autonomi për veriun e Kosovës dhe pastaj të bisedohet për statusin final të Kosovës dhe nëse Serbia është e detyruar të zgjedhë mes BE-së dhe Rusisë, ajo do të zgjedhë BE-në (Savic and Filipovic 2017). Brnabiç vazhdonte se Serbia do të jetë partnere e BE-se dhe mike e Rusisë (B92 2017).

Jadranka Joksimović, ministre për integritet evropian dhe Serbisë, deklaroi se Serbia deri më 2020 do të marrë mbi 1 miliard euro ndihma nga BE-ja për procesin e anëtarësimit (MEI 2017).

Milovan Dreçun, shef i komisionit parlamentar në Kuvendin e Serbisë për Kosovë dhe "Metohi", deklaroi se Gjykata Speciale për krime lufte të kryera nga ish-oficerët e lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është përpjekja e fundit e bashkësisë ndërkombëtare për të gjykuar krimet kundër serbëve dhe joshqiptarëve dhe Serbia do ta ndihmojë këtë proces (Gjykata Speciale, Kosova pret emrat e të akuzuarve 2017).

Ivica Daçiq, deklaroi se Serbia asnjëherë nuk do t'i prishë marrëdhëniet me aleatët e saj të përhershëm që janë Rusia dhe

Kina, për asnjë kusht (RS: MFA 2017). Sipas Brnabiç, Rusia është një partnere e rëndësishme e Serbisë dhe ata duan të thellojnë bashkëpunimin në sektorë zhvillimorë, hulumtues dhe bashkëpunime universitare (B92 2017).

Këto dy veprime të Rusisë dhe Serbisë, janë testet e para bazike që i bëhen “diplomacisë merimangë”.

### *Shpjegimi nëpërmjet diplomacisë merimangë*

Kosova me 26 gusht 2015 nënshkroi marrëveshjen për demarkacionin e kufirit me Malin e Zi (Marrëveshja 2015), ku të njëjtën ditë u protestua në Pejë kundër kësaj marrëveshje, pastaj një ditë pas nënshkrimit të marrëveshjes, një grup profesorësh nga Kosova botojnë një hulumtim për çështjen e demarkacionit të Kosovës me Malin e Zi (Gruda, et al. 2015), ndërsa opozita e atëhershme në Kuvendin e Kosovës në tetor me fillimin e seancave parlamentare, kishte filluar hedhjen e gazit lotsjellës në sallën e Kuvendit, në shprehje të pakënaqësisë me marrëveshjen. Një hulumtim mbi malet e Kopaonikut në veri të Kosovës, ku aty në të kaluarën ka qenë ndërtuar një radar ushtarak telekomandues me rreze veprimi deri në Mesdhe dhe që më pas është bombarduar nga NATO me 1999, male këto që e ndajnë kufirin e Kosovës me Serbinë, gjejmë të dhëna për lëvizje gjeostrategjike të reja. Nga hartat satelitore vërehet se telekomanda ushtarake është rindërtuar dhe sipas gjeoportalit të Serbisë, vija kufitare me Kosovën, është lëvizur për 600 hektarë, (geoSrbija n.d.), ndërsa gjeoportali i Kosovës thotë të kundërtën (Gjeoportali Shtetëror n.d.).

Nga kjo ne kemi parë që qasja e Beogradit në veri të Kosovës do të bëhet duke lejuar Serbinë të marrë kontrollin e Maleve Kopaonik dhe Zubin Potok, dy pika të rëndësishme strategjike, me Malin e Zi në NATO dhe epilogun pozitiv që mori më 21 mars 2018 në Kuvendin e Kosovës pas mosmarrëveshjeve të

brendshme të Kosovës për të kufizuar kufirin me Malin e Zi, me një aktivitet të zgjeruar diplomatik të faktorit ndërkombëtar, do t'i jepte rajonit një perspektivë mbi anëtarësimin në NATO në përgjigje të Ruisë dhe Serbisë me bazat e ushtrisë së tyre në Luginën e Preshevës dhe në vargmalet e Kopaonikut në veri të Kosovës.

Nga kërkesa e Vuçiqit për dialog të brendshëm për Kosovën, në Serbi, kërkesa e Bernabiçit për autonomi për veriun dhe bisedime për statusin e Kosovës, dëshmitë mbi telekomandën ushtarake në Kopaonik dhe vijën kufitare atje, e në anën tjetër çështja e pikave strategjike në Perëndim të Kosovës në kufi me Malin e Zi, tregojnë një skemë ballafaquese merimangë që na dërgon deri te pika ku: Serbia do të mbajë malet e Kopaonikut dhe përballë do të ketë NATO-n, nga Çakorri, Zhlebi dhe Kulla, dhe me këtë pastaj do të lirohen rrugët për observime më teknike mbi zgjidhjen përfundimtare të çështjes së Kosovës, pasi i është siguruar të paktën një pikë strategjike Serbisë dhe Ruisë në Ballkanin Perëndimor.

Nga kjo kemi se “diplomacia merimangë” sipas paradigmës ‘aktorë shtetërorë drejt aktorëve shtetërorë’ tregon se: krijohet një hartë e cila ka shumë leva lëvizëse me qëllim të ruajtjes apo rritjes së influencës së një aktori, nëpërmjet shtjellimeve gjeostrategjike dhe gjeopolitike, ku mund t’i shpjegojë më së miri analiza e politikës së jashtme dhe pragmatizmi i synimeve të tyre. Një aktor e ka të vështirë t’i arrijë synimet e saj qoftë për hapësira të reja gjeopolitike dhe gjeostrategjike apo ruajtjen e influencës, pa shumë veprime, si në një tabelë të madhe shahu.


### *Përfundime*

Ne kemi gjetur një gjerësi argumentesh mbi mënyrat e mundshme për ndërtimin e një teorie ku vetëm disa janë përfshirë dhe sipas nevojës të marrdhënieve ndërkombëtare po



japim një teori bazuar mbi *universalitetin numerik* të Popperit, ku do të mund të mbulonim shpjegimin e veprimeve të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në zona të veçanta. Dhe, këtë nëpërmjet tri paradigmeve të cilat i kemi përmendur më lartë. Kjo na ka mundësuar që t’i qasemi një teorie hibride e cila bazohet në pragmatizmin e aktorëve shtetërorë, në analizën e politikës së jashtme, në realizmin ofensiv dhe defensiv.

Pra, pragmatizmi është pjesa kyçe e këtij koncepti. Diplomacia merimangë nuk është thjesht një koncept i cili shpjegon lëvizjet dhe taktikat e shteteve në politikën e jashtme, por bazohet në analizimin dhe përfshihet në strategjitë afatgjata të cilat kanë një qëllim të qartë dhe synojnë arritjen e saj nëpërmjet betejave në shumë nivele ofensive dhe defensive.



**Figure 4.** *Diplomacia Merimangë dhe pjesët përbërëse*

“Diplomacia merimangë”, mund të mos i qëndrojë kohës dhe të mos jetë i përshtatshëm në shumë stade të studimit, por ky nuk është një disavantazh për këtë koncept, pasi në një botë shumë polare, dinamike dhe me shkenca interdiciplinare edhe teoritë nuk po arrijnë të jenë të afta në shpjegimin e rrethanave dhe parashikimin e tyre.

Te diplomacia merimangë nga shtjellimi i dy shembujve, pamë që efekti i saj në shikim të parë është vetëm një renditje.

Por, nëse kemi parasysh dhjetë shkaqet që dërgojnë në luftë sipas Van Evra-s (1998) ku njëra nga ato shkaqe fliste për strategjitë dhe veprimet sekrete të shteteve me qëllime po ashtu sekrete, diplomacia merimangë na ndihmon që të ndërtojmë një skemë e cila ngjashëm si në shah na jep mundësinë të kuptojmë kurthin se ku dëshiron të dalë aktori shtetëror që ka marrë një iniciativë të tillë.

Diplomacia merimangë është mesazhi i shpjegimit se përse njëri vend apo aleancë është në ofensivë dhe tjetri në defansivë. Pra, diplomacia merimangë qëndron në observimin, elaborimin dhe zbulimin e qëllimeve dhe veprimeve të shteteve apo aleancave, të cilat synojnë mbizotërimin në rajon, kontinent e deri në të qenit hegjemon.

Punimet shkencore të natyrës së tillë janë në numër të vogël ngase koncepti i diplomacisë merimangë është një metodologji që nuk ka ekzistuar më parë, andaj është vështirë të shpjegohet dhe të gjenden avantazhet dhe disavantazhet e saj. Mirëpo, është vetëm një pikënisje ku mirëpret kritikën dhe studimet tjera më të hollësishme, si dhe ky punim në të ardhmen të jetë burim dhe nxitje për hulumtime të tilla. Sidoqoftë, me këtë hulumtim dhe nëpërmjet *diplomacisë merimangë* kemi arritur të argumentojmë veprime të aktorëve shtetërorë që ndryshe nuk do të dilte nga goja e tyre asnjëherë. Teorizimet janë një fushë e vështirë shkencore, dhe ka shumë dogma të ngulitura, që duhet një guxim të trajtosh përtej atyre që dimë, por asnjëherë nuk duhet të jemi të vetëmjaftueshëm dhe të krijojmë varësi teorike, andaj një teori si *diplomacia merimangë* ngjan me një skemë e cila është e verifikueshme dhe e falsifikueshme. Me këtë rast duhet një njohje e mirë e rrethanave dhe një renditje e saktë për të kuptuar dhe shtjelluar qëllimet e aktorëve shtetërorë e joshtetërorë dhe mundësitë reale për arritjen e atyre synimeve.

## Referencat

Almond, G. (1966). Political Theory and Political Science. *The American Political Science*, 869-879.

Bunyavejchewin, P. (2012). Theories of International Politics after the Incident of 9/11: The Richness and Weakness of Realist Tradition in the Twentieth-First Century. *Kasetsart Journal*, 161-169.

Goldstein, J., & Pevehouse, J. (2014). The Globalization of International Relations. In *International Relations*. Washington: Pearson.

Goodhart, C. (1984). Problems of Monetary Management: The UK Experience. *Monetary Theory and Practice*, 91-121.

Gruda, Z., Cërabregu, M., Smaka, R., Isufi, F., Bulliqi, S., Sadiku, M., Osmanaj, S. (2015). *Demarkacioni Kosovë - Mali i Zi*. Pristina: Friedrich Ebert Stiftung.

Hudson, V. M. (2005). Foreign Policy Analysis: Actor-Specific Theory and the Ground of International Relations. *Foreign Policy Analysis*, 1-30.

Lane, R. (1990). Concrete Theory: An Emerging Political Method. *American Political Science Review*, 927-940.

Popper, K. (1950). Miti i origjinës dhe i fatit, Vëllimi 1: Magjia e Platonit. In K. Popper, *Shoqëria e hapur dhe armiqët e saj*. Tiranë: Fan Noli.

Popper, K. (2002). Theories. In *The Logic of Scientific Discovery*. London: Routledge Classics.

Popper, K. (2002). Theory. In *The Logic of Scientific Discovery*. London: Routledge Classics .

Rosenberg, J. (1994). Introduction. In *Empire of civil society*. London: Verso.

Sharma, R. (2017). Përkohshëmëri. In *Ngritja dhe Rënia e Kombeve: Forcat e Ndryshimit në Botën Paskrizës*. Prishtinë: Pema.

Sielski, J. (2007). The "Theory' in the Study of International Relations and Political Science. *Polish Political Science*, 174-185.

Smith, C. (2004). Konflikti arabo-izraelit. In L. Fawcett, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare të Lindjes së Mesme*. Tiranë: UET.

Smith, S. (2013). Introduction: Diversity and Disciplinarity in International Relations Theory. In T. Dunne, M. Kurki, & S. Smith, *International Relations Theories Discipline and Diversity*. Oxford: Oxford University Press.

Surowiecki, J. (2005). *The Wisdom of Crowds*. New York: Random House.

Van Evra, S. (1998). Offense, Defense, and the Causes of War. *International Security*, 5-43.

Walt, S. (1998). International Relations: One World, Many Theories. *Foreign Policy*, 29-46.

## Webliografia

B92. (2017, August 25). Retrieved from [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=25&nav\\_id=102164](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=25&nav_id=102164)

B92. (2017, August 28). Retrieved from [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=28&nav\\_id=102176](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=08&dd=28&nav_id=102176)

B92. (2017, July 4). Retrieved from [http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=07&dd=04&nav\\_id=101716](http://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2017&mm=07&dd=04&nav_id=101716)

B92. (2018, March 12). Retrieved March 16, 2018, from [https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=03&dd=12&nav\\_id=103680](https://www.b92.net/eng/news/politics.php?yyyy=2018&mm=03&dd=12&nav_id=103680)

geoSrbija. (n.d.). Retrieved March 17, 2018, from <https://a3.geosrbija.rs/>

Gjeoportali Shtetëror. (n.d.). Retrieved March 17, 2018, from <http://geoportal.rks-gov.net/>

*Gjykata Speciale, Kosova pret emrat e të akuzuarve.* (2017, Qershor 6). Retrieved from Top Channel:  
<http://top-channel.tv/2017/07/06/gjykata-speciale-kosova-pret-emrat-e-te-akuzuarve/>

Marrëveshja. (2015, August 26). Retrieved March 03, 2018, from kallxo.com:  
<http://kallxo.com/wp-content/uploads/2016/08/Marreveshja-per-Demarkacionin-1.pdf>

MEI. (2017, September 11). Retrieved from  
<http://www.mei.gov.rs/eng/news/456/193/463/details/j-joksimovic-another-eur-1-5-billion-from-eu-ipa-funds-by-2020/>  
RS: MFA. (2017, July 4). Retrieved from

<http://www.mfa.gov.rs/en/press-service/statements/16686-dacic-serbia-will-not-change-its-foreign-policy>

Savic, M., & Filipovic, G. (2017, July 4). *Bloomberg Politics*. Retrieved from Bloomberg:

<https://www.bloomberg.com/news/articles/2017-07-03/serbia-will-pick-eu-over-russia-if-made-to-choose-premier-says>

Zivanovic, M. (2017, November 1). *Balkan Insight*. Retrieved from Balkan Insight:

<http://www.balkaninsight.com/en/article/russia-using-serbia-to-destroy-europe-ukraine-ambassador-10-31-2017>

